



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE TË
ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË

Nr. 2015/11 prot.

Tiranë, më 01.04.2025

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1523, datë 22.11.2010.

SHOQËRISË "BIBA" SH.P.K
Rr. "Halit Bega", Pallati 35, Shkalla 1, Ap. 12, Tiranë

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku "Vasil Shanto", Nr.18, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë

Shoqëria "BIBA" sh.p.k. është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1523. datë 22.11.2010, për mineralin krom, në Objektin "Përroi i Lopës, Luçanë", Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 1303 prot., datë 04.03.2025, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 2015 Prot., datë 06.03.2025, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1523, datë 22.11.2010, për mineralin krom, në Objektin "Përroi i Lopës, Luçanë", Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, pasi subjekti nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit të vitit 2024.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47. pika 1, gërma "ç" të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr. 1523, datë 22.11.2010, për mineralin krom, në Objektin "Përroi i Lopës, Luçanë", Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1523, datë 22.11.2010, për mineralin krom, në Objektivin "Përroi i Lopës, Luçanë", Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

DHE

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME URDHRË PËR DELEGIM

ZËVENDËSMINISTRI

GENI KLOSI

